



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:264119

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05514082

P.nr. 333/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurit I.Q për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1412/2023 e datës 30.11.2023, në bazë të nenit 248 par.1 nën par. 1.4 të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale (tutje KPP), dhe neneve 14, 15, 17 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seancë me datë **27.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me numër të lëndës në ndërmjetësim **ND.nr.22/24 e datës 22.02.2024**, në mes të pandehurit I.Q në një të anë dhe palës së dëmtuar Z.M, në anën tjetër.
- II. **HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1412/2023 e datës 30.11.2023 dhe **PUSHOHET** procedura penale, kundër të pandehurit **I.Q** i lindur me datë ... në fshatin B., ku dhe jeton, Komuna K., me nr. personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.
 - ***Për shkak se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit sipas Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është pranuar zyrtarisht nga gjykata.***

- III. Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, te këtij dispozitivi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.**
- IV. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.**

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Pejë - Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1412/2023 e datës 30.11.2023 kundër të pandehurit I.Q për shkak te veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 2, 4, 8 dhe 12 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe nenin 229 par.1 dhe 2 të KPP-së, këtë çështje penale e ka referuar në ndërmjetësim në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog.

Gjykata **me datë 22.02.2024**, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega Istog, është njoftuar me:

- **Modelin e Marrëveshjes për Ndërmjetësim** (Shtojcën 2), sipas të cilës rezulton se palët e lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, janë pajtuar për ta zgjidhur kontestin e tyre në procedurën e ndërmjetësimit, dhe
- **Modelin e Marrëveshjes për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar** (Shtojcën 3), sipas të cilës rezulton se ndërmjet palëve të lartcekura si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit. E cila marrëveshje pasi që është nënshkruar nga ndërmjetësuesi, është proceduar në gjykatë te gjyqtari i çështjes për aprovim.

Gjykata me vendimin **e datës 26.02.2024** (shtojcën 5), e ka aprovuar marrëveshjen e arritur ne procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform nenit 15 te Ligjit për Ndërmjetësim, e cila marrëveshje është dokument i ekzekutueshëm.

Sipas nenit 248 par. 1, nën par. 1.4 të KPP-së, përcaktohet se Gjykata e hedhë aktakuzën dhe e pushon procedurën kur: *“ i pandehuri dhe i dëmtuari kanë lidhur marrëveshje ndërmjetësimi që është pranuar zyrtarisht nga gjykata ”*.

Gjykata pasi ka vërtetuar se në këtë çështje penale palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimi, duke vlerësuar se marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimi ndërmjet palëve është e paraparë dhe në pajtim me Ligjin për Ndërmjetësim dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, si dhe pas aprovimit të kësaj marrëveshje nga ana e Gjykatës, e duke vepruar konform nenit të sipërcituar 248 par. 1, nënpar. 1.4 të KPP-së, u vendos që të hudhet aktakuza dhe të pushohet procedura penale ndaj të pandehurit si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Konstatimi në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimi ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, bazohet në nenin 229 par.6 të KPP-së.

Gjykata vendimin në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale e ka marrë konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të neni 248 par.1 nën par. 1.4 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA ISTOG

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal

GJYQTARI,
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e pranimit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate. *Në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.*